



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1471 / 1 prot.

Tiranë më 31. 8. 2022

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin “Për miratimin në parim të protokollit për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor”.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

I nderuar zoti Ministër,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 8393/3 prot., datë 25.08.2022, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin “Për miratimin në parim të protokollit për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor” (në vijim, “Projektvendimi”), hartuar në zbatim të Marrëveshjes datë 21.12.2021 “Për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor”, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi Projektvendimi është i hartuar konform kërkesave të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

